

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion

Ligji Nr.10081, datë 23.2.2009 “PËR LICENCAT, AUTORIZIMET DHE LEJET NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” ndër të tjera përcakton procedurat për trajtimin e disa

licencave, të autorizimeve dhe lejeve, në kompetencë të institucioneve qendrore si dhe parimet për përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave, autorizimeve e lejeve, shkaqet e procedurat e revokimit të tyre;

Në reference sa më sipër, ministria përgjegjëse për punësimin dhe aftësitë (MFE), ka në kompetencë të saj shqyrtimin e kërkesave si dhe vendim marrjen për licenca në fushën e:

Shërbime të ndërmjetësimit në tregun e punës dhe/ose formimit profesional:

1. Licencë e kategorisë X.2.A “Ndërmjetësim ne tregun e punës” e cila i jep të drejtën agjencive private të punësimit për të ushtruar aktivitetin e saj në fushën e punësimit;
2. Licencë e kategorisë X.2.B “Formim profesional” e cila i jep të drejtën e subjekteve tregtarë të ushtrorjnë aktivitetin e tyre ne fushën e formimit profesional.

Arsimi para universitar:

1. Licencë e kategorisë IX.1.A.6 Arsimit mesëm profesional;
2. Licencë e kategorisë IX.1.A.7 Arsimit profesional pas së mesmes;

Në faqen zyrtare të QKB-së ju do të gjeni informacion mbi licencat autorizimet dhe lejet e tjera që jepen në Republikën e Shqipërisë
<https://qkb.gov.al/informacion-mbi-proceduren/regjistri-i-licencave-autorizimeve-dhe-lejeve/informacion-mbi-licensat-autorizimet-dhe-lejet/>

Presa i përket praktikave profesionale të nxënësve që ndjekin arsimin profesional, ato janë pjesë e procesit mësimor dhe mënyra e planifikimit dhe zhvillimit të tyre është e rregulluar me urdhër të ministrit përgjegjës për AFP-ne në zbatim të Urdhrit Nr. 220, datë 16.09.2020 për "Miratimin e rregullores për zbatimin e praktikave profesionale në biznese në zbatim të kësaj rregulloreje, praktikant profesional zhvillohen në kuadër të një marrëveshjeje bashkëpunimi midis biznesit dhe IOAFP-së. Nxënësi në periudhën e praktikës është me statusin e praktikantit dhe nuk i paguhen sigurime shoqërore por vetëm siguri në punë dhe është detyrim i punëdhënësit deklarimin e tij në tatime si praktikant dhe pagesën e

sigurimit në punë. Pagesa e praktikantit gjatë periudhës së praktikës është një marrëdhënie jo e detyrueshme midis tij dhe punëdhënësit ku zhvillohet praktika.

Në përgjigje të pikës 3,

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive përsa i takon praktikave profesionale në kuadrin e mbështetjes shtetërore nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit, mbështetur në Ligjin 15/2019 “Për nxitjen e punësimit “; në VKM Nr. 17 datë 15.01.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale” i ndryshuar, zbaton programin e Praktikës Profesionale për të garantuar tranzicion të shpejtë në tregun e punës të studentëve që kanë mbaruar studimet brenda 36 muajve të fundit dhe të nxënësve që mbarojnë shkollat e mesme profesionale.

Në bazë të VKM Nr. 17 datë 15.01.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale” i ndryshuar, programi i Praktikave Profesionale subvencionon praktikantët (studentët dhe nxënësit të diplomuar nga shkollat e mesme profesionale që kanë mbaruar

studimet brenda 36 muajve të fundit) për pjesën e kontributit të sigurimeve të aksidentit në punë në masën 0.3% të pagës minimale të miratuar në shkallë vendi.

Në përgjigje të pikës 6,

Në bazë të VKM Nr. 17 datë 15.01.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale” i ndryshuar, programi i Praktikës Profesionale subvencionon praktikantët për:

- Kontributin e sigurimit për aksidentin në punë për gjithë kohështrirjen e programit (6 muaj)
- Financim i pagës në masën 50% të pagës minimale të miratuar në shkallë vendi.

Në përgjigje të pikës 7,

Siç u përmend më sipër, AKPA në zbatim të VKM Nr. 17 datë 15.01.2020“Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale” i ndryshuar, zbaton programin e praktikave profesionale për studentët dhe nxënësit që kanë mbaruar arsimin e mesëm profesional që kanë mbaruar studimet me një afat deri në 36 muaj.

Në përgjigje të pikes 8,

AKPA është duke kryer procesin e gjurmimit të punëkërkuësve të papunë pjesëmarrës në të gjitha programet e nxitjes së punësimit të zbatuara në vitin 2020-2021, detyrim ligjor që përcaktohet në bazën ligjore të nxitjes së punësimit dhe kryhet 6 muaj pas përfundimit të programit. Ju informojmë se Raporti përfundimtar i Gjurmimit është planifikuar të përfundojë deri në fund të vitit 2022.

Nga të dhënat statistikore gjatë vitit 2021 kanë përfituar nga ky program 1031 praktikantë. Gjatë vitit 2022 deri tani kanë përfituar nga ky program 787 praktikantë, dhe aplikimet vijnë deri në fund të vitit.

Referuar studimit të fundit të gjurmimit të diplomuarve të arsimit profesional të vitit 2021, 57.5 % e tyre punësohen pa përfunduar vitin shkollor, efekt ky direkt i praktikave profesionale që ato kryejnë gjatë periudhës së studimit.